



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4240/1 /Prot.

Tiranë, më 26/07/2022

URDHËR

Nr. 384, datë 26/07/2022

“PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA TË NOTERIT [REDAKTUAR] PËR NJË PERIUdhË 18 (TETËMBËDHJETË) MUAJ DHE DETYRIMIN PËR TË NDJEKUR PROGRAMIN E TRAJNIMIT TË DETYRUAR VJETOR PRANË QENDRËS SHQIPTARE TË TRAJNIMIT TË NOTERËVE, SI DHE NDJEKJEN E NJË PROGRAMI TË PERSONALIZUAR 12 (DYMBËDHJETË) DITOR, NË FUSHËN E TRASHËGIMISË”,

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 1 dhe të gërmës “b”, të pikës 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me urdhrin nr. 644 datë 24.11.2021 të Ministrisë së Drejtësisë është vendosur kryerja e hetimit disiplinor ndaj noterit [REDAKTUAR], me qëllim verifikimin e zbatimit të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, standarteve të sjelljes profesionale, në lidhje me kërkesën e paraqitur nga z. [REDAKTUAR], si dhe regjistrimin e veprimeve/akteve noteriale në sistemin RNSH për periudhën 15.10.2019-03.09.2021.

Në përfundim të veprimeve të kryera nga grupi i kontrollit, si dhe fakteve të raportuara në raportin për kryerjen e hetimit disiplinor, me urdhrin nr. 115, datë 30.03.2022, të Ministrit të Drejtësisë është vendosur nisja e procedimit disiplinor ndaj noterit Valentin Lleshi.

Në vijim të këtij urdhri, me shkresën nr. 1740/3 prot., datë 11.04.2022 kemi informuar Bordin Disiplinor të noterëve mbi rastin, si dhe kemi kërkuar marrjen e masës disiplinore “Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noterit [REDAKTUAR]”, duke përcjellë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e administruar.

Më tej, me shkresën nr. 1740/10 Prot., datë 22.06.2022, Bordi Disiplinor i Noterëve ka përcjellë vendimin nr. 2/2022, datë 06.06.2022, ndaj noterit [REDAKTUAR], në zbatim të Urdhrit të

Ministrit të Drejtësisë nr. 115, datë 30.03.2022, në bazë të nenit 51, pikat 2/b dhe 3 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" i ndryshuar, për të cilin kanë vendosur:

- *Pezullimin nga detyra të noterit Valentin Lleshi për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj;*
- *Detyrimin e noterit Valentin Lleshi për të ndjekur programin e trajnimit të detyruar vjetor pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, si dhe të ndjek një program të personalizuar 12 (dymbëdhjetë) ditor, në fushën e trashëgimisë.*

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të pikës 1 dhe të germës "b", të pikës 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Valentin Lleshi, për periudhën kohore 18 muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Detyrimin e noterit [REDAKTUAR] për të ndjekur programin e trajnimit të detyruar vjetor pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, si dhe të ndjek një program të personalizuar 12 (dymbëdhjetë) ditor, në fushën e trashëgimisë.
2. Caktimin e një noteri nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër për administrimin e arkivës noteriale të noterit [REDAKTUAR], deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. [REDAKTUAR] specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Z. [REDAKTUAR] specialist pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër.
4. Lënien në ruajtje të vulave respektive, vulën e thatë dhe vulën e njomë, të noterit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës;
5. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit menjëherë pasi të njihet me këtë urdhër, të caktoj datën dhe orën e dorëzimit të arkivit, si dhe të njoftoj noterin z. [REDAKTUAR] 5 (pesë) ditë përpara për datën dhe orën e caktuar.
6. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.

7. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe aktëve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivore, nëse ka të tilla.
8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
10. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

